

## Punë Të Rëndësishme - Pjesa 2 nga 4

Mirë se erdhe në këtë seri të veçantë. Uroj shumë që do nxitesh, që Perëndia do të të japë një fjalë që shkon me situatën ku je ti.

Por kush është gati për një gjë të tillë, kush do që të dëgjojë një fjalë nga Perëndia sot?

Seria quhet “Punë të Rëndësishme”, bazuar te një histori e veçantë nga Dhjata e Vjetër, flet për një njeri të zakonshëm, Nehemia quhet.

Pjesën e parë ju nxita për të parë brenda vetes, nëse ka diçka që të bezdis rreth e qark teje.

Mund të jetë ndonjë lloj padrejtësie, diçka që të rëndon në zemër, diçka që duhet bërë por s’po e bën njeri. Mbase është një grup njerëzish që po kalojnë kohë të vështira dhe nuk po gjendet njeri për ta. Ndoshta dikush që është lënë pas dore. Ndoshta dikush mund të thotë: “Është njerëzore që të ndjesh për diçka të padrejtë që sheh.” POR mund të jetë edhe Hyjnore, nëse ti jo vetëm ndjen, por çohesh dhe bën diçka.

Ajo që të rëndon në zemër shpesh ka lidhje me thirrjen tënde.

Me fjalë të tjera, ajo gjë që të rëndon, të shqetëson mund të kthehet në shtysë për të bërë diçka, për të sjellë ndikim në jetën e dikujt. Dhe e di çfarë dua të them? Ti asnjëherë nuk e ke idenë se çfarë ndikimi mund të ketë ajo që po bën ti.

Shiko, Perëndia na ka besuar shërbesa të mëdha, POR kur filluam, asnjë nga ne nuk e kishte idenë se çfarë ndikimi mund të sillte.

*(shënim: mund të përmendni shërbesat e kishës suaj, ndikimin që kanë patur ndër vite)*

Asnjëherë nuk e ke idenë se çfarë ndikimi mund të ketë ajo që filluam, por thjesht: Perëndia po na nxit, ne po e fillojmë, dhe Perëndia ka bërë shumë më shumë nga çfarë kemi imagjinuar.

Ti mund të jesh në fillimet e diçkaje të madhe. Ka shumë gjasa që ty të bezdis diçka. Ti e ke parë një nevojë. Ta ka tërhequr vëmendjen. Ti po e konsideron të bësh diçka. Ose tashmë e ke filluar diçka dhe nuk e ke idenë a do sjellë ndonjë ndikim.

Titulli i serisë quhet Punë të Rëndësishme, kurse titulli i mesazhit sot quhet:

**Bëj Diçka. Ji Ti Ndryshimi.**

Nise punën e rëndësishme, sill ndryshim. Ja t'ju kujtoj diçka nga pjesa e parë. 140 vite më parë—(586 P.K) Babilonët (mbreti Nebukadnezar) pushtuan Jerusalemin dhe e shkatërruan çdo gjë, qytetin e Jeruzalemit, kulturën, vlerat, tempullin, morën shumicën e njerëzve në mërgim, njerëzit u dëshpëruan. Pas disa dekadave një grup Judenjsh u kthyen për të ri-ndërtuar qytetin dhe tempullin. Imagjino, ti ke qenë në mërgim në një nga qytet më të zhvilluara të botës, siç ishte Babilonia në atë kohë. Dhe vjen në qytetin tënd, që është një gërmadhë e tërë. Sikur ka rënë bomba. Nuk ka punë, nuk ka sisteme, nuk ka qeveri, nuk ka drejtues, nuk ka pikë drejtimi, secili bën si t'i vijë, dhe më e rëndësishme: Nuk Ka Pikë Shprese.

Me këtë situatë u përball grupi i parë që shkoi për të rindërtuar qytetin, ata u përpoqën por nuk ia dolën të bënin ndonjë gjë. Ky është konteksti.

DHE 140 vite pas shkatërrimit, një djali të zakonshëm, që quhet Nehemia, iu thye zemra kur dëgjoi se në çfarë gjendje ishte qyteti dhe njerëzit e tij. Dhe ai nuk ishte ndërtues, as politikan, as qeveritar, ai madje nuk kishte as Instagram.

Ai ishte njeri i thjeshtë, që punonte si kupë-mbajtësi i mbretit. Me fjalë të tjera, atij iu thye zemra për një situatë për të cilën ai nuk ishte ekspert i asaj fushe. Por kishte një pasion Hyjnor, i dhënë nga Perëndia.

Nuk e di kujt po i ngjit ky mesazh në këtë pikë. Por ma do mendja që këtu janë shumë persona si ti që nuk ke trajnimin, ti nuk je ekspert i asaj fushe ku po të trazon Perëndia. E vetmja gjë që ti ke është një trazim nga Perëndia për të bërë diçka. Dhe aq të duhet, ky lloj trazimi nga Perëndia është i mjaftueshëm për të sjellë ndryshim.

Kush e mban mend nga java e shkuar? Nehemias iu thye zemra, dhe çfarë ishin tre gjërat që bëri? U ul dhe qau. Ai qau, mbajti zi, agjëroi mjaft kohë. Pastaj, ra në gjunjë dhe u lut. Kemi 12 raste kur Nehemia u lut, në librin e Nehemias. Ai këmbëngulte para Perëndisë së qiellit në lutje. Dhe së fundmi ai u çua dhe filloi të bënte diçka, ai u trazua dhe tha, “Dikush duhet të bëjë diçka”. Ky dikushi mund të jem unë.

Po mirë, si ta bëj këtë punën e rëndësishme? Si të sjell ndikim?

Dua të ndaj 4 ide me ty, shumë praktike dhe uroj që do jetë fiks diçka që shkon me atë që po kërkoje. Lejoje Frymën e Perëndisë të fuqizojë, të flasë, të inkurajojë për të sjellë ndryshim.

Cila është e para?

## **1 - Do Kërkojmë Fytyrën e Zotit Rregullisht.**

Nehemian e shikon që herë pas here, lutet, shkon para Perëndisë në lutje, lutet e lutet. Shiko, e di sa gjatë u lut Nehemia?!...

Dëgjoi lajmin në Nëntor dhe u lut për 4 muaj (muaji Kisleu deri në muaj Nisan).

Nehemia u lut 4 muaj rresht. Ai u lut, agjëroi, po kërkonte fytyrën e Perëndisë.

Pse po lutet kaq shumë, po pse? Ai po kërkon drejtimin e Perëndisë në këtë gjë sepse është kupë-mbajtës por Perëndia po e thërret për një gjë të re.

Ai po lutet edhe sepse ishte kupë-mbajtës dhe do ia sillte këtë kërkesë mbretit për t' u shkëputur nga puna. Por, ishte e vështirë sepse detyra e kupë-mbajtësit ishte t' i hiqte halle mbretit, jo t' i shtonte halle. Madje në këtë kohë, mbretërit e lindjes së mesme, nëse i sillje një lajm dhe mbretit nuk i pëlqente, urdhëronte që të vriteshe direkt. Kështu që mbretit i thuheshin vetëm lajmet e mira.

Nehemia është në pozitë të vështirë. Ja si thuhet...

**Nehemia 2:1-2. 4-5** “... Unë nuk kisha qenë i trishtuar kurrë në prani të tij. Prandaj mbreti më tha: "Pse ke pamje të trishtuar, ndonëse nuk je i sëmurë? Kjo nuk mund të jetë veçse një trishtim i zemrës". Mbreti më tha: "Çfarë kërkon?". Atëherë unë iu luta Perëndisë të qiellit dhe pastaj iu përgjigja mbretit...”

Shiko çfarë marrëdhënie miqësore ka Nehemia me mbretin. Mbreti e njohu, Nehemia nuk është sëmurë, është i shqetësuar. Dhe mbreti i tha “Çfarë kërkon, çfarë ke, Nehemia?”.

Ky është njish more vëlla. Shiko çfarë lidhje, çfarë miqësie ka me Perëndinë. Çdo gjë ia kërkon Perëndisë. Ai lutet gjatë te shtëpia, por lutej shkurt para çdo mundësie. Ka ndërtuar një miqësi aq të fortë me Perëndinë, sa që tani vetëm sa i çon një lutje sms në whatsapp. Një fjali.

Nuk është momenti për lutje të gjata. Por lutesh aq rregullisht sa që tani, thjesht thua një lutje të shkurtër. “Perëndi, më jep fjalët e duhura, Zot, më ndihmo tani, Perëndi, më jep urtësi tani. Perëndi, më drejto, më trego, më mëso.”

Në prani të mbretit e ke Nehemian, mbreti i thotë çfarë do, ai lutet dhe pastaj përgjigjet.

Kur vjen puna te lutja:

Nuk ka gjë të madhe që Perëndia ynë nuk mund të bëjë, nuk ka gjë të vogël që Perëndia mos ta dijë ose të mos merakoset.

Ai kujdeset për çdo gjë. Nëse diçka të rëndon zemrën, sille tek Ai. Kërkoje Perëndinë.

*(shënim: mund të ndani një situatë ku një person është lutur për x shërbesë, dhe Perëndia ka bekuar shumë personin, shërbesën dhe personat që kanë njohur Perëndinë prej kësaj shërbese.)*

Nuk ka gjë të madhe që Perëndia ynë nuk mund të bëjë, nuk ka gjë të vogël që Perëndia mos ta dijë ose të mos merakoset.

Si fillohet puna e rëndësishme?

Së pari duke kërkuar rregullisht fytyrën e Perëndisë. Më drejto, më fol, më pajis.

Nehemia e kërkoi Perëndinë për 4 muaj.

Për ty që ke diçka që të rëndon në zemër, ke vizion për diçka, filloje me lutje.

Nëse nuk ke nevojë për t'u lutur për vizionin/ëndrrën tënde, i bie që ke një ëndërr të vogël.

Nëse po synon diçka të madhe, do të hedhësh hapa besimi, të duhet fuqia e madhe e Perëndisë.

Pra, si ia fillon punës së rëndësishme? Si mund të sjellësh ndikim me jetën tënde?

Së pari, kërko Perëndinë rregullisht.

## **2-Përkufizoje Qartë Vizionin Tënd.**

Shiko, troç fare. Shumicës së njerëzve nuk u mungon dëshira, u mungon qartësia. Cila është thirrja, qëllimi, gjëja jote?

Po Nehemia, a ishte i qartë për atë që po synonte?

**Nehemia 2:5** “...*“Në qoftë se kjo i pëlqen mbretit dhe shërbëtori yt ka gjetur mirëdashje në sytë e tu, më lejo të shkoj në Judë, në qytetin e varreve të etërve të mi, që ta rindërtoj atë.”*”

Ai mund ta thoshte atë që donte në 1 fjali. Shumë e qartë. Lejomë të shkoj në Jude që ta rindërtoj atë. Kaq.

Së pari kërko Perëndinë rregullisht, së dyti përkufizoje qartë atë që po synon.

Shumica e njerëzve që synojnë diçka nuk janë të qartë dhe i bien nga Kina. Nehemia nuk tha:

“Eeee, mbret, kam qenë duke menduar këto ditë, në fakt 4-5 ditë, sepse kishte postuar hallë Meremja një status në Facebook. Se hallën e kam në Jeruzalem, se di a ta kam thënë? S'ta kam thënë? Halla ime jeton në Jeruzalem, ka një

byrektore, ka 3 kalamaj, i madhi është Miri. Miri ndau një link që kishte qenë në lajme para një jave. Njerëzit janë në pikë të hallit andej më duket. Po nuk ishte dhe shumë e qartë çfarë halli kishin, se Miri vetëm fillore ka mbaruar. Meqë se marr vesh hallin se çfarë kanë, dua të shkoj vetë për një vizitë. Të shoh një herë dhe pastaj, duke parë, duke bërë.

Dhe u lodha duke provuar verën tënde, madje një natë pashë ëndërr sikur vdiqa nga vera e helmuar dhe ti s'ma ke rritur rrogën fare këto vitet e fundit. Madje nuk më bërë tag mua te darka e fundit që kishe me mbretin arab. Aty isha, në foto, duke mbushur gotën tënde.

Plus që s'kam bërë pushime në atdhe, të gjithë kthehen në atdhe në Gusht, i gjen fisi ndonjë nuse, unë ngela beqar duke të shërbyer ty mbret. Kështu jam duke e menduar. Akoma nuk jam i sigurtë eee, se mos e merr seriozisht. Se postime facebook-u janë, se Miri merr kot nganjëherë kur nuk i jep plaka lekë për kafe. Po ide e mirë është, si mendon ti mbret?"

“Uooo, ça je duke thënë more djalë se më bërë lëmsh, ça bën kjo rinia e sotme, të gjithë tymosin këta?!”

Por, shpesh kështu i ndodh shumicës, nuk e vrasin mendjen që nuk e kanë të qartë idenë.

Çfarë do që të bësh? Për çfarë po të thërret Perëndia? Disa, për të ndihmuar fëmijët. Po për çfarë? Po si? Cilin grup fëmijësh? Ata që s'kanë çanta shkolle, ata që kanë probleme për të bërë detyrat, ata që nuk shkojnë në shkollë fare? Ata që janë të abuzuar, ata që s'kanë shtëpi? Ku? Në cilin qytet, lagje? Në Shqipëri apo jo? Je mjek, do ndihmosh dikë me talentin tënd? Kë do ndihmosh?

Nëse nuk e thua me pak fjalë, nuk mund ta realizosh!

Troç fare, nëse nuk e përcakon qartë, nuk e arrin dot. Nëse Perëndia po të thërret, qartësoje.

Perëndia na ka thirrur ne si kishë për të ndryshuar këtë qytet dhe vend. Çfarë synimi kemi? 2% të Shqiptarve. Po pse? Sepse 2% është masa kritike për të krijuar një Lëvizje që do të shpërthejë në gjithë vendin dhe do sjell gjithë vendin te Perëndia. A është e qartë kaq?

Mbreti i tha: “Çfarë kërkon?” Nehemia tha:” Më lejo të shkoj në Jude që të rindërtoj muret. Kaq dua.” Në një fjali. Ku po të drejton Perëndia ty? 1 fjali. Shumë qartë.

Çfarë po të drejton TY Perëndia për të bërë?

Të kem një familje që e do Perëndinë shumë dhe njëri-tjetrin.

Të shlyejmë borxhet deri në 2025.

Të ndaj ungjillin me 1 person në javë.

Të ndaj ungjillin me koleg, shok/shoqe të klasës.  
Të filloj një biznes që të ndihmoj kishën me financat.

Ndoshta Perëndia po të thërret të ndihmosh një adoleshent të mundi një varësi, pornografi, ta rrëfejë, të pendohet dhe të çlirohet prej saj.  
Do të ndihmoj çdo javë 2 orë në një nga festimet e kishës.  
Do vij të pastroj ndërtesën e kishës 1 herë në muaj.  
Do bëj këtë, atë....

A mund ta thuash me një fjali?  
Si bëhet puna e rëndësishme? Si mund të sjellësh ndikim me jetën tënde? Së pari, kërkon Perëndinë rregullisht, së dyti e përkufizon qartë vizionin tënd.

Cila është e treta?

### **3 - Bëj Plane Të Kujdesshme.**

Bëj plane praktike. Si do arrish atje? Synimi pa një plan është thjesht një dëshirë. Idetë e mira pa një plan, janë kot. Bëj një plan. Nderoj Perëndinë.

A e di çfarë, disa herë gjëja më shpirtërore që ti duhet të bësh është të organizosh ditën, javën, jetën tënde.

Perëndia është Perëndi sistematik. Ne jetojmë në sistemin diellor që ka 7 ditë në javë, çdo javë prapë 7 ditë janë. Nuk ka javë me 6 apo me 8. Viti nuk ka 400 ditë, ka 365, një herë në katër vite ka 366. Perëndia është Perëndi sistematik.

Kjo është një nga gjërat që unë po mësoj nga Nehemia këto ditë. Nuk e kam problemin te vizioni, as te qartësia e vizionit, e kam problemin te hapat praktik, sistemimi.

Shiko se sa specifik është Nehemia për planin që kishte, sa i kujdesshëm.

**Nehemiah 2:6-7** *"Mbreti më tha (mbretëresha i rrinte ulur në krah): "Sa do të zgjasë udhëtimi dhe kur do të kthehesh?". Kështu i pëlqeu mbretit të më lërë të shkoj dhe unë i tregova një afat kohe. Pastaj i thashë mbretit: "Në rast se kështu i pëlqen mbretit, të më jepen letra për qeveritarët e krahinës matanë Lumit që të më japin lejen e kalimit deri sa të arrijë në Judë,"*

Sa do zgjasë udhëtimi? Nehemia nuk i tha: "Po ku di unë. Po shkove atje, jemi fis i madh ne, duhet të shkosh për qofte tek të gjithë dhe duhet të lësh 50 euro shtëpi për shtëpi."

Nuk tha:" Prit të marr çikë Mirin në whatsapp. Ai nuk tha: "Nuk e di, shohim e bëjmë."

Ishte shumë i kujdesshëm. “Më duhen letra për të kaluar. Më duhet mbrojtje.”

**Nehemiah 2:8** “...dhe një letër për Asafin, mbikëqyrësin e pyllit të mbretit, që të më japë lëndën e drurit për të ndërtuar portat e qytezës së bashkuar me tempullin, për muret e qytetit dhe për shtëpinë në të cilën do të shkoj të banoj”. Mbreti më dha letrat, sepse dora mirëdashëse e Perëndisë tim ishte mbi mua.”

Po i kërkon mbretit mbrojtje, mbështetje. Është shumë i qartë. Kërkoji siguri gjatë udhëtimit, materiale për të ndërtuar.

Si mbyllet vargu 8? Sepse dora mirëdashëse e Perëndisë tim ishte mbi mua.

Ai e kuptoi që ishte Perëndia që e kishte drejtuar hap pas hapi. Ai ishte i qartë si kristali dhe gati për veprim.

Bëri planin dhe tha: Ja sesi do e realizoj.

Ndoshta po thua, “Unë mund ta bëj një lloj plani po nuk e bëj dot të përsosur.” Nuk duhet të jetë i përsosur, përmirësohet rrugës, hap pas hapi.

E di cili është plani im ditë pas dite? “Zot, më ndihmo të bëj gjënë e duhur sot.” Ji besnik sot, bëj gjënë e duhur sot. Ji i qartë. Cili është plani yt? Pastaj takon dikë, merr këshilla. Kërko video në YouTube, tako dikë që është i suksesshëm në atë që do të bësh ti.

Cila është e katërta gjë për t’u bërë?

#### **4 - Frymëzoi Njerëzit Plot Pasion.**

Nehemia çohet, frymëzon njerëzit plot pasion. Çdo gjë është e mundur me Perëndinë.

**Nehemiah 2:8** “Atëherë u thashë atyre: “Ju e shikoni gjendjen e mjeruar në të cilat ndodhemi: Jeruzalemi është shkatërruar dhe portat e tij janë konsumuar nga zjarri! Ejani, t’i rindërtojmë muret e Jeruzalemit, dhe kështu nuk do të jemi më të turpëruar!”. U tregova pastaj atyre sesi dora plot favor e Perëndisë tim kishte qenë mbi mua si dhe fjalët që mbreti më kishte thënë...”

Ai iu thotë hapur, nuk po e fsheh situatën. Pastaj i frymëzon, ejani t’i rindërtojmë muret...

Perëndia është me ne. Perëndia po vepron. Perëndia është në anën tonë. Frymëzoi njerëzit në atë që të ka dhënë Perëndia. Ai nuk do të na lërë, nuk do të na braktisë. Ai do na fuqizojë. Ai shkon para nesh, ai do hapë dyert që nuk mundemi ne ti hapim. Ai na jep favor para të tjerëve.

Frymëzoi njerëzit, bëje me pasion atë që të ka besuar Perëndia. Xhon Uesli ka një thënie të bukur për këtë:

“Ndizu plot zjarr dhe pasion dhe te tjerët do vijnë kilometra larg për të parë sesi po digjesh.” Xhon Uesli

Le të ndërtojmë mbretërinë e Perëndisë bashkë. Le të sjellim sa më shumë njerëz që të njohin dashurinë e Tij dhe Shpëtimtarin. Çfarë të rëndon ty? Besoje atë gjë dhe frymëzo të tjerët të bëhen pjesë me ty. Nehemia tha: “Tu tregova për favorin e Perëndisë dhe fjalët e mbretit.” Kur është nga Perëndia, të trazon ty por trazon edhe të tjerët rreth e qark teje.

Si mund të sjellësh ndikim? Si mund ta realizosh Punën e Rëndësishme? Së pari, kërko Perëndinë rregullisht. Përcaktoje qartë vizionin; Bëj plane me kujdes; Frymëzo njerëz me pasion.

Le të lutemi

Cili është hapi tjetër për ty?

A e gjen veten te gjërat që po ndodhin?

A është diçka e re?

Lutja e shpëtimit